



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT/ TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI/ PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH. Nr. 333/12

**PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT**, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, në përbërje prej: **z. Hysni HOXHA -Kryetar, z. Osman KRYEZIU – Referues, z. Tefik SYLEJMANI –anëtar**, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE „TALI“-Gjilani, lidhur me aktivitetin e prokurimit „**Mirëmbajtja Dimrore e rrugëve 2012/2013, në Komunën e Gjilanit – Ndarja në dy Lote**”, me Nr. të Prokurimit:GI 651/12/111/221, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Gjilanit me datë: 06.12.2012 mori këtë :

**V E N D I M**  
**MBI APROVIMIN E ANKESËS SË OE „TALI“-GJILANË, ME NR. 333/12 TË DATËS:09.11.2012**

**I. Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE „TALI“-Gjilanë, lidhur me procedurën e prokurimit me titull: „**Mirëmbajtja Dimrore e rrugëve 2012/2013, në Komunën e Gjilanit – Ndarja në dy Lote**”, me Nr. të Prokurimit:GI 651/12/111/221, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Gjilanit .

**II. Anullohet**, vendimi i Autoritetit Kontraktues /Komuna e Gjilanit/, për dhënie të kontratës, lidhur me procedurën e prokurimit me titull „**Mirëmbajtja Dimrore e rrugëve 2012/2013, në Komunën e Gjilanit – Ndarja në dy Lote**”, me Nr. të Prokurimit:GI 651/12/111/221, si i pa bazuar.

**III. Urdhërohet**, Autoritetit Kontraktues /Komuna e Gjilanit/, që procedurën e prokurimit me titull „**Mirëmbajtja Dimrore e rrugëve 2012/2013, në Komunën e Gjilanit – Ndarja në dy Lote**”, me Nr. të Prokurimit:GI 651/12/111/221, ta kthej në **Ri-vlerësim**.

Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin Shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të LPP-së Nr. 04/L-042, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues, që nuk respekton vendimin e Panelit Shqyrtues të paraparë me këtë ligj.

IV. Meqenëse pretendimet ankimore të operatorit ekonomik ankues „TALI”-Gjilanë janë të qëndrueshme, konform nenit 118.3 të LPP-së i kthehet sigurimi i ankesës në shumë prej: 500.00 € (pesëqind euro).

### ARSYETIM

Operatori Ekonomik „TALI”- Gjilanë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP-së, me dt: 09.11.2012, me Nr. 333/12, kundër njoftimit për dhënie të kontratës të OE „MAGJISTRALJA”- Gjilanë, duke pretenduar se Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjilanit, ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të LPP-së Nr. 04/L-042 siç janë:

- Neni 6 i LPP-së – Ekonomiciteti dhe efikasiteti;
- Neni 7 i LPP-së – Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi;
- Neni 8 i LPP-së – Planifikimi i prkurimit;
- Neni 9 i LPP-së – Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur;
- Neni 27 i LPP-së – Dosja e tenderit;
- Neni 28 i LPP-së – Specifikimet teknike;
- Neni 38 i LPP-së – Kontrata Publike kornizë;
- Neni 55 i LPP-së – Mënyra e komunikimit;

Organi Shqyrtues i Prokurimit pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së Nr. 04/L-042, ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të shqyrtuar procedurën e zhvilluar lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, si dhe vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues, në raportin e tij të datës: 26.11.2012 , konstaton se OE i rekomanduar për kontratë “MAGJISTRALJA”, ka ofruar vertetimin nga Gjykata Eonomike e Qarkut, kopje dhe ku ceket se ky OE ka procedur kontestimore: me nr.IIIC-3/12= 14,893.00 € dhe IIIC-4/12=35,318.00 €.

Eksperti shqyrtues në raport njëkohësisht ka konstatuar, se OE ankues "TALI" SHPK, ju ka drejtuar në mënyr elektronike AK-së me dt:30.10.2012, ku ka kërkuar qasje në dokumentat e OE të rekomanduar për kontratë, ndërsa AK-së me dt:02.11.2012, ju ka përgjegjur duke i rekomanduar, se për qasje në dokumentat zyrtare, mund të drejtoheni në zyren për Mardhënje me Qytetar. Pas kësaj OE ankues "TALI", me dt:05.11.2012, bënë kërkesë pran kësaj zyre, mirpo AK-së, me dt:12.11.2012, ju kthen përgjegje se mund të keni qasje, por pas ardhjes së ankesës në OSHP-ë.

Eksperti shqyrtues, gjithashtu ka konstatuar se OE "INTEGRAL", ka ofruar vertetim mbi takasat komunale ku ceket se ky OE i ka kryer pjesrisht obligimet, dhe sipas nenit 23.6 të Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik, Vertetimet në lidhje me kërkesat e përshtatshmëris do të kërkojnë të dorzohen nga një tenderues të cilit AK-së, që ka për qëllim dhënien e kontratë, pra si i tillë ky OE është i përgjegjshëm.

Ndërsa lidhur me pretendimet e OE ankues, eksperti shqyrtues konstaton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, nuk është bërë konform nenit 59, si dhe nuk është respektuar neni 10 i LPP-së, andaj konsideron se ankesa e OE ankues është e bazuar.

Në fund të raportit të tij, eksperti shqyrtues, duke u bazuar në konstatimet e cekura në raportin e ekspertizës konstaton se Autoriteti Kontraktues – Komuna e Gjilanit, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja dimrore e rrugëve 2012/2013, në Komunen e Gjilanit – Ndarje në dy Lote", me Nr. të Prokurimit GI 651/12/111/221, nuk i ka zbatuar procedurat e prokurimit konform LPP-së Nr. 04/L-042, prandaj rekomandon që të anulohet vendimi i AK-së, për dhënje të kontratës, dhe lënda të kthehet në rivlersi, si dhe të aprovohet ankesa e OE ankues si e bazuar.

OE ankues „TALI“-Gjilanë, në parashtrësën e dt: 29.11.2012 ka deklaruar se pajtohet me mendimin dhe rekomandimin e ekspertit shqyrtues të dhënë në raportin e tij të datës: 26.11.2012.

AK-së, me datën:30.11.2012, me anë të parashtrësës ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me raportin dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues, për këtë aktivitet të prokurimit.

Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor të datës: 06.12.2012, në të cilën ishin prezent anëtarët e panelit shqyrtues, eksperti shqyrtues, përfaqësuesi i OE ankues, përfaqësuesi i AK-së, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, përgjigjja e AK-së, mbi raportin e ekspertizës, parashtrësja e OE ankues lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Gjatë prezantimit në seancë, përfaqësuesi i OE ankues „TALI” deklaroi se përveq asaj që kamë potencuar në ankesën e datës: 09.11.2012, më duhet të shtojë, se zyra e prkurimit në KK Gjilanë, pas kësaj ankese na ka njoftuar me dt:13.11.2012, se mund të kemë qasje në dokumentat zyrtare, ndërsa të nesërmen me dt:14.11.2012, na njofton se lënda është shkuar në OSHP-ë, çka do të thot se une si OE, nuk kam pasur qasje në dokumentat e OE të rekomanduar për kontratë, ku gjithmon kam dyshuar në dokumentacionin e këtij OE, dhe besoj se ky OE nuk mundë të përmbushë këtë kontratë me AK-së, pasi OE i rekomanduar për kontratë është një kompani e cila nuk e ka përmbushur as një kontratë me AK-së, edhe pse i ka disa projekte me AK-së, të nëshkruara që dy vite e më shumë, e të cilat nuk janë përmbushur deri me tani.

Ne si OE dyshojmë se në këtë rastë nga zyra e prokurimit ka pasur manipulime siq ka pasur, edhe me mirmbajtjen verore të këtij viti, ku sotë e asaj dite gropat në Komunën e Gjilanit janë të hapura, nga OE i shpërblyer me kontratë. Arsya është se AK-së, ka nëshkruar kontratë me një OE i cili ka ofruar çmime 0.01 € dhe 0.02 €, pra edhe në rastin konkret AK-së dëshiron të lidhë kontratë me një OE të falimentuar, e cila ka konteste të hapura pranë Gjykatës Ekonomike të Prishtinës, dhe atë në procedurën kontestimore me nr.IIIC-3/12=14.893.00€ dhe IIIC/4=35.318.00 €, ku këtë e dëshmonë edhe Vertetimi i lëshuar nga kjo Gjykatë. Për fundë deklaroj se qëndroj në tërësi pran ankesës time, dhe kërkoj që ky aktivitet i prokurimit të kthehet në rivlersim sepse është zhvilluar në kundërshtim me nenet 10 dhe 59 të LPP-së.

Gjatë prezentimit në seancë përfaqësuesi i AK-së, deklaroi se sa i përket konstatimit nr.1, eksperti shqyrtues konstaton se kinse ne kemi zhvilluar procedur me vler të madhe, dhe ky konstatim nuk qëndron.

Ndërsa sa i përketë Vertetimit nga Gjykata Ekonomike, askund në dosje të tenderit dhe në njoftimin për kontratë, nuk është kërkuar ky Vertetim nga Gjykata Ekonomike. Është e vërtetë se ky OE ka procedur konstatimore pranë Gjykatës Ekonomike për mosë shlyrje të obligimeve, por nuk dim sa do të zgjatë ky proces, dhe nuk jemi të informuar se ky OE është në falimentim. Po ashtu është e vërtetë se OE ankues ka kërkuar qasje në dokumentat zyrtare, mirpo menaxherja e Prokurimit e ka orjentuar që ankesën t’ia drejtojë zyres për mardhënje me qytetaret, dhe gjithashtu është e vërtet se ka qenë një lëshim nga ana jonë, pasi këtë kërkesë është dashur ta prananim ne si zyrë e Prokurimit.

Gjatë prezantimit në seancë, eksperti shqyrtues deklaroi se sa i përketë konstatimit nr.2, në dosjen e tenderit në pikën a. Shkruan “për situatën e referuar pikës 6.2 dhe pikës 6.3”, vërtetohet se AK-së ka kërkuar vërtetim nga Gjykata kompetente për gjendjen e OE, se a janë të përgjegjshëm administrativisht, dhe në pikpamje financiare.

Gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë ”MAGJISTRALJA”, ka ofruar një Vertetim nga Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë, ku në vërtetim ceket se ky OE ka procedur kontestimore për dy lëndë, lënda e parë nr.IIIC-3/12=14.893.00 €, dhe IIIC-4/12=35.318.00€.

Ndërsa sa i përket konstatimit nr.3, OE "TALI", ka kërkuar qasje në dokumenta zyrtare me dt:05.11.2012, ndërsa AK-së, e ka sygjëruar OE ankues se ky mundë të bëjë ankesë pranë zyres për mardhënje me qytetarë, qka kjo bie ndesh me nenin10.3 të LPP-së. Po ashtu është interesant për tu cekur se zyra e prokurimit, pas ankesës së OE , në shkresat e lëndës ka ofruar se gjoja kjo zyrë i ka ofruar qasje në dokumentat zyrtare këtijë OE me dt:06.11.2012.

Kurse sa i përket konstatimit nr.4, mendoj se nuk kam çka të shtojë më shumë, se të gjitha gjërat janë sqruar në raportin e ekspertizës të dt:26.11.2012.

Në vazhdim njëri nga antarët e panelit shqyrtues pyeti përfaqësuesin e AK-së dhe ekspertin shqyrtues, se në dosjen e tenderit, a është kërkuar Vertetimi nga Gjykata Ekonomike e Qarkut në Prishtinë.

Në përgjigjen e tijë përfaqësuesi i AK-së deklaroi se gjatë shiqimit të dosjes së tenderit këtu në seancë, në faqen16, shihet se është kërkuar ky vertetim nga Gjykata Ekonomike, mirpo këtë lëndë nuk e kam punuar unë, por një zytar tjetër i Prokurimit.

Ndërsa eksperti shqyrtues deklaroi, po në faqen 16, të dosjes së tenderit është kërkuar Vertetimi nga Gjykata Ekonomike e Qarkut.

Po ashtu i njëjti anëtar i panelit shqyrtues, prapë e pyeti përfaqësuesin e AK-së, dhe ekspertin shqyrtues, se a është kërkuar në dosjen e tenderit, vertetimi për përmbushjen e obligimve të taksave komunale. Në përgjigjen e tij eksperti shqyrtues konfirmoi se në dosjen e tenderit në faqen 16. pika 3 është kërkuar dëshmi se OE nuk janë në vonesë për pagesat komunale së paku deri në tre mujorin e fundit para dorzimit të tenderit. Dhe në rastin konkretë OE "INTEGRAL", ka ofruar një vertetim të tillë, por që njëjti i ka kryer pjesërishtë këto obligime komunale.

Paneli Shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, raportit të vlerësimit të komisionit vlerësues të AK-së, shqyrtimit të pikave pretenduese të parashtruesit të ankesës, konstatimeve, analizën konkrete dhe rekomandimin e ekspertit shqyrtues të cekur në ekspertizë, parashtrësës së OE ankues, parashtrësës së AK-së, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, konstatoj dhe vlerësoj, se OE ankues nuk e ka plotësuar kërkesën e AK-së lidhur me pranueshmerin e operatoëve ekonomikë, vertetimin nga Gjykata Ekonomike e Qarkut, të parapara në nenin: 6.4 të FDT-së, pasi OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar një vertetim nga Gjykata Ekonomike, ku ceket se i njëjti ka konteste pranë kësajë Gykate për lëndët me nr.IIIC-3/12=14.893.00 €, dhe IIIC-4/12=35.318.00€.

Paneli Shqyrtues, duke u bazuar në dokumentet e prezentuara në seancë, konstaton se AK-së, nuk i ka ofruar qasje në dokumentat zyrtare OE ankues "TALI", me arsyetime tëndryshme, edhe pse i njëjti konform nenit 10 të LPP-së, ju ka drejtuar disa herë këtijë AK-së.

Paneli Shqyrtues, konstaton se OE "INTEGRAL", ka ofruar një vertetim për taksat komunale, ku ceket se ky OE, ka kryer pjesërisht obligimet për taksat komunale. Ndërsa sa i përket vërtetimit për Taksat komuale, Paneli shqyrtues, konstaton se konform nenit 23 të Udhëzuesit Operativ për prokurim publik, vërtetimet në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë do të kërkohen të dorëzohen nga një tenderues të cilin AK-së, që ka për qëllim dhënien e kontratës.

Paneli shqyrtues konstaton se ankesa e OE ankues „TALI”, është e bazuar, pasi që AK-së gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti nuk i ka respektuar nenet: 7, 10 dhe 59 të LPP-së, pasi që ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform dispozitave të LPP-së, dhe me këtë rast AK-së nuk i ka trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë operatorët ekonomik. Kështu që paneli shqyrtues vjen në përfundim se ankesa e OE ankues është e bazuar dhe urdhëron AK-së, që gjatë ri vlerësimit të ofertave të bazohet në dispozitat ligjore të prokurimit publik.

Andaj, paneli shqyrtues, duke u bazuar në nenin:117 të LPP-së dhe duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

#### **Këshillë Juridike :**

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur nuk mund të ushtron ankesë, por për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh, pas pranimit të këtij vendimi, me kërkesë-padi mund ti drejtohet. Gjykatës Supreme të Kosovës

